



UNIONI I KËSHILLAVE STUDENTORË

Tiranë, më 08/05/2020

DEKLARATË

Unioni i Këshillave Studentorë përshëndet urdhërin e nxjerrë nga *Ministria e Arsimit dhe Sportit* për shtyrjen e datës së zgjedhjeve për autoritetet dhe organet drejtuese në *Institucionet Publike të Arsimit të Lartë*. Të cënosh lirinë dhe të drejtën legjitime të studentëve për të zgjedhur dhe për t'u zgjedhur është akt i paligjshëm dhe sulm ndaj demokracisë në tërësi.

Për këtë arsye edhe pse te vonuar, ne e quajmë të drejtë këtë urdhër të Ministrisë së Arsimit dhe Sportit.

Por problematikat e studentëve nuk janë zgjidhur me këtë urdhër. *Unioni i Këshillave Studentorë* ngre dhe njëherë shqetësimin e studentëve në lidhje me tarifën e shkollimit për këtë vitë akademik. Duke u ndodhur në një situatë jo të zakonshme, përballimi i saj nga studentët haset në vështirësi për shkak të prezencës së munguar në auditore por edhe rikthimi i tyre nuk i plotëson muajt që i kanë humbur apo munguar në universitet.

Ne vazhdojmë të përsërisim dhe njëherë kërkesën:

1. Rishikimi i tarifave të universitetit për vitin akademik 2020;

Me mirëkuptim, shpresojmë që kësaj here kjo kërkesë mos të bjeri në vesh të shurdhër, por të pasohet me një tjetër vendim nga *Ministria e Arsimit dhe Sportit*.

Vendim ky që do të jetë sërish në favor të studentëve, të cilët janë qelizat më vitale në zhvillimin e vendit!

Mbetemi në pritje të përgjigjes tuaj.

Sinqerisht,

Studentët Tuaj